

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 05.01.2022

- **SHITËSI- Z. Xhafer Vata**, shtetas Shqiptar, i lindur në Tirane, Shqiperi më 14/01/2001 banues në Tirane, madhor, me zotesi te plote për të vepruar, i pajisur me numer Karte Identiteti: **Nr. K10114038I**.
- **BLERESI –Znj. Eleonora Pantaloni**, shtetase Italiane, e lindur në Roma (RM), Itali më 25/09/1970 banuese në Albano Laziale (RM), Itali, madhore, me zotesi te plote për të vepruar, e pajisur me numer dokumenti indentifikimi: **Nr. YB4969322**.

BAZA LIGJORE

Referuar dispozitave ligjore

- Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
- Ligji Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme
- Kodi Civil
- Akti i Themelimit e Statuti i Shoqërisë
- Data e rregjistrimit eshte 24/12/2021

OBJEKTI

Mbi bazën e ekstraktit të Shoqërisë “LEGALTECH” sh.p.k, shitesi **Z. Xhafer Vata** eshte ortak i cili gezon **100,00 % ta kapitalit te shoqerise me numer pjesesh 1,00 dhe vlere kapitali 100.000,00**

Mbi bazën e dokumentave të sipërcituar, përpilojmë këtë kontratë shitje kuotash me objekt:

- **Shitesi** i shtet bleserit 100 % të kuotave që zotëron në Shoqërine “LEGALTECH” sh.p.k, kundrejt vlerës totale **100.000,00** Leke (njqindemije leke),likujdimi i së cilës do të realizohet në rrugët e parashikuara në ligj në një moment të dytë pas nënshkrimit të kësaj kontrate që do të përcaktohet me mirëkuptim. Ne momentin e neshkrimit te Kontrates Pala blesese merr persiper te gjithë detyrimet qe ka pala shitese ndaj institucioneve shteterore ose ndaj institucioneve private ose individeve. Palët bien dakort që ky ndryshim të pasqyrohet në QKB pasi kontrata e shitjes se kuotave te regjistrohet ne QKB.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate **Z. Xhafer Vata** zhvishet nga pronësia si dhe detyrimeve ndaj institucioneve shteterore ose ndaj institucioneve private ose individeve dhe deklaron se heq dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar përfitime të çdo lloji për këtë sasi kuotash, po kështu heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim mbi dividendet dhe çdo përfitim tjetër nga aktiviteti i shoqërisë në një masë prej 100 % duke pranuar këtë transaksion.

Ndarje e re e dividendit do të bëhet në masën 100 % per **Znj. Eleonora Pantaloni**, shtetase Italiane, e lindur në Roma (RM), Itali më 25/09/1970 banuese në Albano Laziale (RM), Itali, madhore, me zotesi te plote për të vepruar, e pajisur me numer dokumenti indentifikimi: **Nr. YB4969322**, e cila do te jete Ortake e Veteme e shoqerise “LEGALTECH” shpk.

- Mbas nënshkrimit të këtij Akti e pasqyrimit të QKB Shoqëria pëson këto ndryshime:

Ishte:


- **Z. Xhafer Vata**, shtetas Shqiptar, i lindur në Tirane, Shqiperi më 14/01/2001 banues në Tirane, madhor, me zotesi te plote për të vepruar, i pajisur me numer Karte Identiteti: **Nr. K10114038I**, zotësues i 100% të kapitalit në Shoqërise “LEGALTECH” sh.p.k.

Bëhet:

- Në bazë të vendimit, Ortak i vetem i shoqerise “LEGALTECH” sh.p.k do te behet **Znj. Eleonora Pantaloni**, shtetase Italiane, e lindur në Roma (RM), Itali më 25/09/1970 banuese në Albano Laziale (RM), Itali, madhore, me zotesi te plote për të vepruar, e pajisur me numer dokumenti indentifikimi: **Nr. YB4969322**, me 100% te kapitalit te Shoqerise me vlere nominale te barabarte me 100.000,00 Leke.

SHITËSI

Xhafer Vata



BLERËSI

Eleonora Pantaloni

ELEONORA PANTALONI

